
EPOKA E RE

E përditshme e pavarur
Viti XXVI, nr. 8435
E enjte, 18 nëntor 2026
Çmimi 0. 50 €

Nga mesazhet mashtruese te hetimi: Si i heton Policia mashtrimet online?

FAQE 6



Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com
facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

DHOMAT E SPECIALIZUARA NË HAGË KANË AUTORIZUAR NJË VIZITË TË ISH-KRYETARIT TË KUVENDIT DHE ISH-ZËDHËNËSIT TË USHTRISË ÇLIRIMTARE TË KOSOVËS (UÇK), JAKUP KRASNIQI, NË KOSOVË, PËR ARSYE HUMANITARE

LOT, MALL DHE PËRQAFIME, JAKUP KRASNIQI PËR DISA ORË VIZITON FAMILJEN NË KOSOVË

FAQE 4-5



Jakup Krasniqi ka arritur të mërkurën në Kosovë për një vizitë familjare disaorëshe, të cilën ia kanë lejuar Dhomat e Specializuara në Hagë për arsye humanitare. Burime të gazetës “Epoka e re” kanë bërë të ditur se vizita e Krasniqit lidhet me gjendjen shëndetësore të bashkëshortes së tij. Ai është sjellë në shtëpinë e tij në lagjen Velania të Prishtinës, nën përcjelljen e rrepta të pjesëtarëve të EULEX-it dhe Policisë së Kosovës. Në hyrje të shtëpisë, Krasniqi është pritur nga familjarët e tij. Pamjet e publikuara nga mediat kanë shfaqur një takim tejet emocional, të përcjellë me lot, përqafime dhe dhimbje

AKTUALE



ZYRTARI I PENTAGONIT: LUFTA NË UKRAINË PRITET TË VAZHDOJË GJATË GJITHË DIMRIT, ME GJITHË PËRPJEKJET PËR MARRËVESHJE

F. 2

KOALICIONI SHQIPTAR I GATSHËM PËR DIALOG ME PUSHTETIN E RI NË SERBI, S’HEQ DORË NGA KËRKESAT

F. 2

EKONOMI



KU SHKUAN 13.4 MILIARDË EURO TË BUXHETIT TË KOSOVËS? RAPORTI I GAP-IT ZBULON SE CILAT FUSHA MORËN MË SË SHUMTI

F. 8

SIGURIA ENERGJETIKE E KOSOVËS NUK MUND TË NDËRTOHET VETËM ME VENDIME POLITIKE

F. 8

Safet GËRXHALIU



SPORT



KOSOVA E MBYLL EDICIONIN E PESTË TË LIGËS SË KOMBEVE, MBETET NË LIGËN B

F. 11

PAS MË SHUMË SE DY VJETËSH, KOSOVA I RIKTHEHET LOBIMIT NË SHBA

F. 3



STRATEGJIA PËR MBROJTJEN E ISH-KRERËVE TË UÇK-SË NË APEL, SHIROKA PULA PRET GRUPIN PUNUES: KOHA PËR UNITETIN POLITIK E INSTITUCIONAL

F. 7



RENOVA PUTZ
Maqedoni Xhepçisht -Tetovë Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009 +389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA GROUP SH.P.K.
NDËRTIM PROJEKTIM SHITJE
INFO: 049-111-101, 044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · ÇUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website, Marketing...

ZYRTARI I PENTAGONIT: LUFTA NË UKRAINË PRITET TË VAZHDOJË GJATË GJITHË DIMRIT, ME GJITHË PËRPJEKJET PËR MARRËVESHJE



UASHINGTON, 18 NËNTOR - Një zyrtar i lartë i Pentagonit u ka thënë aleatëve të NATO-s se Moska ka të ngjarë ta vazhdojë luftën në Ukrainë të paktën edhe gjatë muajve të dimrit, me gjithë përpjekjet e Uashingtonit për ta ndërmjetësuar një armëpushim dhe një marrëveshje për paqe mes Rusisë dhe Ukrainës.

Nënsekretari amerikan i Mbrojtjes, Elbridge Colby, i bëri këto komente më 17 nëntor në Bruksel.

Gjatë një takimi me anëtarët e aleancës në kryeqytetin belg, Colby u përball gjithashtu me kritika të ashpra nga aleatët e SHBA-së dhe Ukrainës për deklaratat e tij kundër sulmeve të fundit të Kievit thellë brenda Rusisë.

Colby mori pjesë në një takim të Grupit të Kontaktit për Mbrojtjen e Ukrainës, i cili është grupim joformal i rreth 50 shteteve, që bashkërendon mbështetjen ushtarake për Ukrainën mes aleatëve perëndimorë. Ai njihet edhe si Grupi i Ramsteinit.

Nënsekretari amerikan i Mbrojtjes tha se, "me ardhjen e dimrit, duket se Rusia do të vazhdojë të grumbullojë edhe më shumë trupa dhe ta përdorë ekonominë për ta zgjatur luftën". Ai shtoi se të gjithë duhet të jenë të përgatitur që lufta "të vazhdojë".

Colby tha se presidenti amerikan, Donald Trump, mbetet "plotësisht i përkushtuar për t'i dhënë fund këtij konflikti, me kushte që garantojnë paqe të qëndrueshme".

Trump pritet të marrë pjesë në një takim në qytetin kinez, Shenzhen, së bashku me presidentin rus, Vladimir Putin, dhe liderin kinez, Xi Jinping, ku pritet të diskutohet për luftën dhe përpjekjet e ndryshme për t'i dhënë fund asaj.

Në të njëjtën ditë, të dërguarit e Trumpit për paqe, dhëndri i tij Jared Kushner dhe Steve Witkoff, pritet të marrin pjesë në një takim në Berlin me Koalicionin e Vullnetit, grupit të udhëhequr nga Gjermania, Franca dhe Britania, i krijuar për të mbështetur përpjekjet ndërmjetësuese të Uashingtonit dhe për të shqyrtuar mundësinë e krijimit të një misioni paqeruajtës, në rast se arrihet marrëveshje armëpushimi në Ukrainë.

"Sulmet nuk patën ndikim"

Colby e kritikoi gjithashtu Ukrainën për sulmet që ka kryer rishtazi thellë brenda Rusisë. Në shënjestër të atyre sulmeve kanë qenë objektet energjetike ruse dhe depot e gjigantit rus të tregtisë elektronike, Wildberries. "Vlerësimi ynë është se këto sulme nuk kanë qenë efektive në përshpejtimin e përfundimit të luftës dhe as nuk kanë ndihmuar në frenimin e përparimit të Rusisë në vijën e frontit", tha Colby. "Për më tepër, sulme të tilla, veçanërisht ato që shënjestrojnë infrastrukturën civile, siç janë objektet e Wildberries, me gjasë e kanë forcuar edhe më shumë vendosmërinë e popullit rus dhe gatishmërinë e vetë Kremlinit për ta përshkallëzuar konfliktin", shtoi ai.

Megjithatë, ai theksoi se "Ukraina nuk duhet të detyrohet të luftojë me duart e lidhura pas shpine", duke shtuar se sulmet "e përqendruara në vijën e frontit dhe në mbështetjen e drejtpërdrejtë të luftimeve në atë zonë janë çështje tjetër, natyrisht".

Deklaratat e tij vijnë në kohën kur Ukraina goditi urën strategjike dhe simbolike të Kërçit, e cila lidh Rusinë me gadishullin ukrainas të Krimesë, të aneksuar jashtëligjshëm nga Moska. Kjo ka bërë që përpjekjet e Kremlinit për ta furnizuar rajonin e pushtuar të kufizohen ndjeshëm. Ura është e vetmja lidhje e drejtpërdrejtë rrugore dhe hekurudhore mes Rusisë dhe gadishullit në Detin e Zi.

Kievi ka goditur objektiva brenda Rusisë në përgjigje të intensifikimit të sulmeve të Kremlinit ndaj infrastrukturës civile ukrainase, përfshirë objektet energjetike. Këto sulme kanë shkaktuar mungesa të karburantit në prag të muajve të dimrit, që pritet të jenë veçanërisht të vështirë.

Kryeministri ukrainas, Serhiy Koretskiy, i tha Radios Evropa e Lirë më 16 nëntor se Rusia synon "t'ua shuajë vullnetin" ukrainasve në kohën kur po hyn dimri.

Kritikat e Colbyt për sulmet e Ukrainës thellë brenda Rusisë u kundërshtuan nga aleatët amerikanë dhe ukrainas.

Ministri gjerman i Mbrojtjes, Boris Pistorius, i cilësoi këto kritika si "veprim mjaft i pamend". "Në vend që të kritikohet Ukraina për sulmet në thellësi të territorit rus, është më mirë të kritikohen sulmet terroriste që kryhen çdo natë dhe çdo ditë ndaj infrastrukturës energjetike, ujësjellësit dhe ngrohjes në Ukrainë", u tha ai gazetarëve, duke iu referuar sulmeve të pareshtura ruse ndaj objekteve civile ukrainase.

Ministri britanik i Mbrojtjes, Wes Streeting, shprehu të njëjtin qëndrim, duke thënë se sulmet e Ukrainës "kanë ndihmuar në dobësimin e makinerisë së luftës së Putinit, duke fituar kohë dhe duke shpëtuar jetë".

KOALICIONI SHQIPTAR I GATSHËM PËR DIALOG ME PUSHTETIN E RI NË SERBI, S'HEQ DORË NGA KËRKESAT

PRISHTINË, 18 NËNTOR - Deputetët shqiptarë në Kuvendin e Serbisë janë të gatshëm për dialog, bashkëpunim dhe partneritet me autoritetet e reja në Serbi, por se mbeten prapa kërkesave të tyre sa i përket pozitës së shqiptarëve në Luginën e Preshevës. Kështu tha gjatë seancës konstituive në Kuvendin serb deputeti nga Koalicioni Shqiptar, Shaip Kamberi.

Tetë parti shqiptare garuan së bashku në zgjedhjet e 25 tetorit në Serbi, duke fituar dy mandate. Zgjedhjet i fitoi Lista Studentore, duke siguruar 140 nga 250 mandate në Kuvend dhe duke rrëzuar nga pushteti pas 14 vjetësh Partinë Përparimtare Serbe të ish-presidentit Aleksandar Vuçiq.


Gjatë seancës konstituive, e cila nisi një ditë më parë, Koalicioni Shqiptar shprehu mbështetje për kandidaturën e kësaj liste për kryeparlamentar, Aleksandar Çupiq. Kundërkandidat i tij është Stojan Radenoviq, i propozuar nga partia e Vuçiqit.

Deputetët e Kuvendit të Serbisë po vazhdojnë për të dytën ditë radhazi diskutimet për kandidatët për kryetar të Kuvendit. Kreu i ri i Parlamentit do të jetë edhe ushtrues detyre i presidentit të Serbisë.

Duke folur për kërkesat e shqiptarëve në Serbi, Kamberi tha se ato nuk janë të reja dhe se shumë çështje thelbësore ende nuk janë zgjidhur. Ai u shpreh se presin përfaqësim real të shqiptarëve në institucionet shtetërore, zgjidhjen e çështjes së njohjes së diplomave, ndalimin e pasivizimit të adresave, përmirësimin e arsimit, përfshirë sigurimin e teksteve shkollore në gjuhën shqipe, si dhe zhbllokimin e fondit që Këshilli Kombëtar Shqiptar merr nga institucionet e Kosovës. "Do ta mbështesim çdo nismë dhe jemi të gatshëm për partneritet në zgjidhjen e këtyre çështjeve, por nuk do të heqim dorë nga parimet dhe kërkesat tona", tha Kamberi.

"Vetë e drejta për barazi nuk është e negociueshme", shtoi ai.

Shqiptarët në Luginë të



Preshevës vazhdimisht ankohen për diskriminim dhe nënpërfaqësim institucional në Serbi, por edhe për atë që njihet si pasivizim i adresave.

Pasivizimi nënkupton fshirjen e qytetarëve nga adresat ku kanë qenë të regjistruar. Ky veprim rezulton me humbjen e shtetësisë serbe dhe, rrjedhimisht, të drejtave civile, përfshirë të drejtën për të votuar, për të pasur pronë, për të përfituar sigurim shëndetësor e pension, si dhe për t'u punësuar.

Kjo çështje është ngritur vazhdimisht nga shqiptarët në Luginë, por edhe nga Kosova, që e cilëson si praktikë diskriminuese.

Pasivizimi i adresave ishte përmendur edhe në një raport të Departamentit amerikan të Shtetit më 2023, ku thuhej se kjo praktikë ishte zbatuar në mënyrë joproporcionale ndaj shqiptarëve, sidomos në Medvegjë.

Edhe Komisioni Evropian në raportet për Serbinë kishte ngritur shqetësimet për pasivizimin e adresave të shqiptarëve.

Fituesja e zgjedhjeve në Serbi, Lista Studentore ka premtuar përmirësimin e të drejtave të pakicave në gjuhë, arsim, kulturë dhe informim.

Më herët, Kamberi i kishte thënë Radios Evropa e Lirë se ndryshimi i pushtetit në Serbi nuk garanton vetvetiu një qasje tjetër ndaj shqiptarëve.

Sipas tij, autoritetet e reja do të vlerësohen në bazë të hapave konkretë për zgjidhjen e problemeve të shqiptarëve.

Lista Studentore, e cila ka fituar mjaftueshëm vota që ta formojë e vetme ekzekutivin, nuk ka treguar konkretisht nëse do të bashkëpunojë me partitë e pakicave.

Ndryshe, gjatë seancës konstituive, mbështetje për kandidaturën për kryeparlamentar nga Lista Studentore shprehën edhe deputetët e pakicave të tjera në Serbi.

Gjatë seancës, Mirollav Andriq, deputet nga Lista Studentore, tha se kandidati i tyre për kryeparlamentar do ta bëjë Kuvendin serb "një shtëpi me të cilën do të krenohen të gjithë qytetarët".

Ndërkaq, Ana Bërnabiq nga Partia Përparimtare Serbe tha se kandidati i tyre, Stojan Radenoviq, është personi më i kualifikuar për këtë post.

Vuçiq - i cili dha dorëheqje nga posti i presidentit të Serbisë për të marrë pjesë në zgjedhjet e 25 tetorit - deklaroi para deputetëve se nuk do ta çojë deri në fund mandatin e tij si deputet, sepse siç u shpreh ai, dëshiron që t'ia lërë postin të rinjve.

Me konstituimin e Kuvendit, sipas ligjeve në Serbi, Qeveria e re do të duhet të formohet brenda 90 ditësh.

EPOKA E RE

Botohet nga "Epoka e re" • Kryeredaktor: Mal QORRAJ
• Drejtor i përgjithshëm: Sadik ZEQIRI (Tel: 044 127 434, dhe 049 127 434 e-mail: sadikzeqiri@yahoo.com)
• ADRESA: Prishtinë, përballë ish-Selisë Qendrore të UNMIK-ut
• Tel: 038/227-557, e-mail: epokaere_mm@hotmail.com & mm_epokaere@yahoo.com

PAS MË SHUMË SE DY VJETËSH, KOSOVA I RIKTHEHET LOBIMIT NË SHBA



PRISHTINË, 18 NËNTOR - Pas më shumë se dy vjetësh pa asnjë lobist të angazhuar në Shtetet e Bashkuara, këtë muaj Kosova ka lidhur marrëveshje me një kompani amerikane për t'i përfaqësuar interesat e saj në Uashington.

Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës (MPJD) ka lidhur kontratë me kompaninë amerikane Ballard Partners, e cila do të ofrojë këshillim strategjik dhe shërbime të marrëdhënieve me institucionet qeveritare amerikane, sipas një dokumenti të regjistruar në Departamentin amerikan të Drejtësisë, në kuadër të Aktit për Regjistrimin e Agjentëve të Huaj (FARA).

Kontrata është dorëzuar në FARA më 13 nëntor dhe ka hyrë në fuqi më 15 nëntor 2026, për një periudhë njëvjeçare.

Sipas marrëveshjes, Kosova do t'i paguajë kompanisë 50 mijë dollarë në muaj, apo gjithsej 600.000 dollarë për një vit. Kësaj shume i shtohen edhe shpenzimet e arsyeshme të udhëtimit dhe përfaqësimit, të cilat duhet të miratohen paraprakisht nga MPJD-ja.

Pagesat do të bëhen në këste tremujore prej 150.000 dollarësh.

Të njëjtën kompani e pati angazhuar edhe zyra e Presidencës në vitin 2017, kur postin e presidentit e mbante Hashim Thaçi.

Në kontratë, të nënshkruar nga ministri i Jashtëm, Glauk Konjufca, dhe presidenti i kompanisë, Brian Ballard, thuhet se Ballard Partners do të këshillojë dhe përfaqësojë Kosovën lidhur me çështje që i konsideron të nevojshme dhe të përshtatshme për t'u trajtuar pranë Qeverisë federale amerikane.

Dokumenti i regjistruar në FARA përmend lobimin dhe avokimin, përgatitjen dhe shpërndarjen e materialeve informative, si dhe diskutimin e mundësive të reja të bashkëpunimit ndërmjet Shteteve të Bashkuara dhe Kosovës.

Megjithatë, kontrata nuk specifikon objektiva konkrete politike për të cilat kompania do të angazhohet në emër të Kosovës.

Radio Evropa e Lirë ka kontaktuar Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës për më shumë informacione, por nuk ka marrë ende përgjigje.

Kjo Ministri, kishte lidhur kontratat e fundit të lobimit në SHBA në vitin 2023, kur udhëhiqej nga Donika Gërvalla, tani ministre e Drejtësisë.

Kosova pa kontrata lobimi që nga viti 2024

Në qershor të vitit 2023, Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës (MPJD) kishte angazhuar dy kompani për lobim në SHBA: Afërdita Rakipi Communications LLC, në pronësi të Afërdita Rakipit, dhe Ambal LLC, në pronësi të Avni Mustafajt.

Sipas kontratave të nënshkruara më 26 qershor 2023, të dyja kompanitë u angazhuan për nga një vit, me synimin e deklaruar për "avancimin e marrëdhënieve dypalëshe mes SHBA-së dhe Qeverisë së Kosovës". Secila parashihej të paguhej nga 147 mijë euro, pra gjithsej 294 mijë euro.

Përveç pagesave të kontratës, ata kishin deklaruar edhe shpenzime shtesë, kryesisht për ushqim dhe udhëtime. Një pjesë e madhe e takimeve të deklaruara ishin zhvilluar në restorante në Prishtinë, ndonëse kontrata parashihte këshilla strategjike dhe përfaqësim të MPJD-së në SHBA.

Të dhënat e publikuara në FARA tregonin se, nga korriku 2023 deri në janar 2024, Rakipi kishte deklaruar dy kontakte, ndërsa Mustafaj katër. Në disa raste, të dy kishin raportuar takime me të njëjtët zyrtarë amerikanë në të njëjtën datë.

Kontratat përfunduan në fund të qershorit 2024 dhe nuk u vazhduan. Që nga atëherë, Kosova nuk ka pasur asnjë lobist në SHBA, ndërkohë që vendet e rajonit kanë nënshkruar disa të tilla.

Angazhimi i rajonit për lobim në SHBA

Kontratat e vendeve të rajonit tregojnë se ato po përpiqen të avancojnë interesat e tyre në Uashington përmes lobimit.

Në vitet e fundit, Serbia ka zgjeruar angazhimin e saj në Uashington, përmes disa kontratave aktive me kompani amerikane: me KARV Communications, për komunikim strategjik dhe marrëdhënie me mediat, me pagesë prej rreth 60 mijë dollarësh në muaj; me Valcour LLC, për promovimin e Serbisë si nikoqire e EXPO 2027, me 65 mijë dollarë në muaj; dhe me CRB Global LLC, për këshillim strategjik, me 10 mijë dollarë në muaj.

Përveç qeverisë, në regjistrin amerikan figurojnë edhe kontrata të Odës Ekonomike të Serbisë dhe dy kompanive private serbe.

Edhe Republika Sërpska, entitet i Bosnje e Hercegovinës, ka rritur ndjeshëm shpenzimet për lobim në SHBA në vitet e fundit. Në 16 kontratat aktive, një nga objektivat kryesore del të ketë qenë heqja e sanksioneve amerikane ndaj udhëheqësit të atëhershëm të entitetit, Milorad Dodik, dhe personave të lidhur me të.

Ndërkohë, Mali i Zi figuron me dy kontrata aktive, të dyja të nënshkruara në muajt e fundit të këtij viti. Njëra u lidh nga Organizata Kombëtare e Turizmit dhe tjera nga Partia Demokratike Popullore.

Nga institucionet shtetërore të Shqipërisë nuk figuron asnjë kontratë aktive lobimi, por vetëm një nga Partia Demokratike e Shqipërisë dhe të tjera nga individë dhe kompani private.

Ngjashëm, edhe Maqedonia e Veriut figuron në regjistrin FARA vetëm përmes angazhimeve të një kompanie private, ATS Group, dhe një partie politike, Bashkimi Demokratik për Integrim.

Teksa vendet e rajonit përpiqen t'i avancojnë interesat e tyre në Uashington, lobimi në SHBA ka rëndësi të veçantë për Kosovën për shkak të rolit amerikan në sigurinë e vendit dhe në proceset ndërkombëtare që e prekin.

Vitin e kaluar, kur Kosova s'kishte asnjë kontratë lobimi aktive, analistja politike Donika Emini kishte vlerësuar për REL-in se Kosova nuk mund të mbështetet vetëm në diplomacinë konvencionale, përmes ambasadave dhe konsullatave.


Sipas saj, në një kohë kur Serbia po e forcon angazhimin në Uashington, mungesa e një pranie aktive të Kosovës rrezikonte ta linte vendin në hije.

"Uashingtoni nuk është një vend ku vlerësohesh vetëm për vullnetin e mirë; është një fushëbetejë e influencës, ku lobimi, partneritetet strategjike dhe aftësia diplomatike përcaktojnë se kush zë vend në tavolinë", kishte thënë Emini për REL-in.

Fëllanza Podrimja emërohet zëvendësministre e Punëve të Jashtme dhe Diasporës

PRISHTINË, 18 NËNTOR - Kryeministri i Republikës së Kosovës, Albin Kurti, ka emëruar Fëllanza Podrimja në pozitën e zëvendësministres në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës.

Kryeministri Kurti e uroi Podrimjan për detyrën e re dhe i dëshiroi suksese në përmbushjen e përgjegjësive të reja.



DHOMAT E SPECIALIZUARA NË HAGË KANË AUTORIZUAR NJË VIZITË TË ISH-KRYETARIT TË KUVENDIT DHE ISH-ZËDHËNËSIT TË USHTRISË ÇLIRIMTARE TË KOSOVËS (UÇK), JAKUP KRASNIQI, NË KOSOVË, PËR ARSYE HUMANITARE

LOT, MALL DHE PËRQAFIME, JAKUP KRASNIQI PËR DISA ORË VIZITON FAMILJEN NË KOSOVË

Jakup Krasniqi ka arritur të mërkurën në Kosovë për një vizitë familjare disaoréshe, të cilën ia kanë lejuar Dhomat e Specializuara në Hagë për arsye humanitare. Burime të gazetës "Epoka e re" kanë bërë të ditur se vizita e Krasniqit lidhet me gjendjen shëndetësore të bashkëshortes së tij. Ai është sjellë në shtëpinë e tij në lagjen Velania të Prishtinës, nën përcjelljen e rrepta të pjesëtarëve të EULEX-it dhe Policisë së Kosovës. Në hyrje të shtëpisë, Krasniqi është pritur nga familjarët e tij. Pamjet e publikuara nga mediat kanë shfaqur një takim tejet emocional, të përcjellë me lot, përqafime dhe dhimbje



EPOKA E RE **Mal QORRAJ**

PRISHTINË, 18 NËNTOR - Ish-kryetari i Kuvendit të Kosovës dhe ish-zëdhënësi i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), Jakup Krasniqi, ka arritur të mërkurën në Kosovë për një vizitë familjare disaoréshe, të cilën ia kanë lejuar Dhomat e Specializuara në Hagë për arsye humanitare.

Burime të gazetës "Epoka e re" kanë bërë të ditur se vizita e Krasniqit lidhet me gjendjen shëndetësore të bashkëshortes së tij.

Ai është sjellë në shtëpinë e tij në lagjen Velania të Prishtinës, nën përcjelljen e rrepta të pjesëtarëve të EULEX-it dhe Policisë së Kosovës.

Në hyrje të shtëpisë, Krasniqi është pritur nga familjarët e tij.

Pamjet e publikuara nga mediat kanë shfaqur një takim tejet emocional, të përcjellë me lot, përqafime dhe dhimbje.

Në një përgjigje për Gazetën Express, Dhomat e Specializuara kanë konfirmuar se Trupi Gjykues e ka udhëzuar Zyrën e Regjistrimit që ta organizojë këtë vizitë.

Michael Doyle ka deklaruar se kjo është vizita e 15-të e një personi të paraburgosur në Kosovë, e autorizuar nga gjyqtarët e Dhomave të Specializuara për arsye humanitare.

Gjykata ka bërë të ditur se vizitat e tilla lejohen në bazë të Rregullës 56 të Rregullores së Procedurës dhe të Provave, e cila mbështetet në standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, përfshirë nenin 5 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Rregullat Standarde Minimale të Kombeve të Bashkuara për Trajtimin e të Burgosurve.

Në përgjigjen për Express, zëdhënësi i Dhomave të Specializuara ka sqaruar se kërkesat e tilla shqyrtohen nga gjyqtari ose gjyqtarët përgjegjës për rastin, të cilët i vlerësojnë të gjitha rrethanat në kohën e paraqitjes së kërkesës, duke marrë parasysh urgjencën dhe ndjeshmërinë e situatës.

Doyle nuk ka dhënë detaje për rrethanat konkrete humanitare që kanë çuar në autorizimin e vizitës së Krasniqit. "Për shkak të arsyeve bindëse humanitare, Trupi Gjykues e ka udhëzuar Sekretariatin që të organizojë një vizitë të personit të paraburgosur në Kosovë për Jakup Krasniqin. Kjo është vizita e 15-të e këtij lloji nga një person i paraburgosur në Kosovë, e autorizuar nga gjyqtarët e Dhomave të Specializuara për arsye humanitare dhe e organizuar nga Gjykata deri më sot.



Vizita të tilla të personave të paraburgosur lejohen në bazë të Rregullës 56 të Rregullores së Procedurës dhe të Provave të DHSK-së, e cila është miratuar nga gjyqtarët dhe mbështetet në të drejtën ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, përfshirë nenin 5 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Rregullat Standarde Minimale të Kombeve të Bashkuara për Trajtimin e të Burgosurve", ka deklaruar Doyle. "Kur një person i paraburgosur paraqet një kërkesë të kësaj natyre, gjyqtari ose gjyqtarët përgjegjës për çështjen i vlerësojnë të gjitha rrethanat në kohën e paraqitjes së kërkesës, duke marrë parasysh urgjencën dhe ndjeshmërinë që kërkojnë situata të tilla. Ata vendosin në bazë të kuadrit ligjor të DHSK-së dhe standardeve ndërkombëtare për të drejtat e njeriut", ka deklaruar më tej Doyle.

Kjo nuk është hera e parë që Krasniqit i lejohet të vizitojë familjen në Kosovë. Vizitën e parë të përkohshme ai e kishte realizuar me rastin e vdekjes së vëllait të tij.

Më 10 tetor 2024, Krasniqi kishte ardhur në Kosovë, ku kishte vizituar familjen dhe kishte bërë homazhe te varri i vëllait.

Ai ishte arrestuar nga Dhomat e Specializuara më 4 nëntor 2020, ndërsa më 16 shtator 2026 ishte dënuar me 25 vjet burgim.

Ndërkaq, kryetari i Organizatës së Veteranëve të Luftës së UÇK-së

→





(OVLUÇK), Hysni Gucati, ka thënë se bashkëshortja e ish-zëdhënësit të UÇK-së, Jakup Krasniqi, është në gjendje të rëndë shëndetësore.
Ai ka deklaruar në një lidhje të drejtpërdrejtë në emisionin KosovaLive në T7 se nuk mund të japë shumë detaje lidhur me gjendjen shëndetësore të bashkëshortes së Krasniqit. "Unë kam qenë në dijeni që Jakup Krasniqi do të vijë këtë javë. Jo për sot, por e kam ditur se brenda kësaj jave do të vijë për vizitë familjare, për shkak se bashkëshortja e tij, Sevdija, është në gjendje të rëndë shëndetësore", ka thënë ai. "Baca Jakup ka ardhur në vizitë humanitare, të cilën ia ka lejuar Gjykata, për ta vizituar bashkëshorten e tij, e cila është në gjendje shumë të rëndë shëndetësore", ka deklaruar Gucati.
Deputetja e Kuvendit të Kosovës, bashkëshortja e Rexhep Selimit, Shqipe Mehmeti Selimi, përmes një postimi në "Facebook" ka shkruar se sot, më shumë se çdo herë më parë, janë pranë dhe në mbështetje të zonjës Sevdije dhe bacës Jakup, në këto kohë të vështira për ta dhe për të gjithë familjen Krasniqi. "Zonjës Sevdije i urojmë shërim të shpejtë dhe shëndet të plotë. Forca dhe qëndresa janë tipare të përhershme të saj", ka shkruar ajo.

Qytetarët mblidhen pranë shtëpisë së Krasniqit

Lajmi për ardhjen e Jakup Krasniqit në Kosovë ka bërë që qytetarë të shumtë të mblidhen pranë shtëpisë së tij në lagjen Velania të Prishtinës, me shpresën se do të kenë mundësi ta takojnë. Në mesin e tyre ishte edhe Çlirim Haziri nga iniciativa "Jo në emrin tim", i cili tha se kishin ardhur për ta parë Krasniqin, por pa bërë thirrje publike, në mënyrë që të mos shkaktonin tensione apo të rrezikonin ndërprerjen e vizitës së tij familjare.
Haziri tha se përmes pranisë së tyre dëshironin t'i tregonin ish-zëdhënësit të UÇK-së se nuk është i vetëm në përballjen me procesin gjyqësor në Hagë. "Ma lart në shtëpinë e tij, qysh është emocion për familjen, është emocion edhe për ne. Edhe për këtë arsye, pa bërë thirrje publike dhe për shkak që nuk i di procedurat dhe protokollin - na kemi mundësi me ia prish këtë vizitë ndoshta e pa dashur me i tensionua - erdhëm këtu me një grup për me pa Bacën Jakup nëse do të na lejohet", ka deklaruar Haziri para mediave.





Ai ka thënë se dëshirojnë ta shohin Krasniqin dhe t'i përcjellin mbështetjen e tyre.
"Kemi dëshirë ta shohim heroin tonë, njeriun që po e përfaqëson luftën e fundit të Ushtrisë Çlirimtare, dinjitetshëm në ato Dhoma të Specializuara e t'i tregojmë se nuk është vetëm, po është bashkë me krejt Kosovën në betejën e fundit të Kosovës për drejtësi, për liri dhe për shtetësinë e saj. Do ta takojmë gjithsesi", ka thënë ai.

Vëllai i Krasniqit tregon pse nuk arriti ta takonte

Vizita e Jakup Krasniqit në familjen e tij ka qenë e shoqëruar edhe me emocione për familjarët që nuk patën mundësi ta takonin.
Vëllai i tij, Daut Krasniqi, ka treguar se nuk arriti ta takonte gjatë qëndrimit të tij në shtëpi, pasi nuk dëshironte të rrezikonte mbarëvajtjen e vizitës.
Ai ka thënë se vajza e Jakup Krasniqit e kishte këshilluar të mos hynte në shtëpi, në mënyrë që të mos rrezikohej ndërprerja e vizitës. "Vajza e tij më tha: 'Bac, veç na prish rendin neve, na e ndalin vizitën'. Thashë: 'Jo bre, për me prish nuk po du, me ndreq diçka, se e prishtë është boll'", ka deklaruar Daut Krasniqi para mediave.

STRATEGJIA PËR MBROJTJEN E ISH-KRERËVE TË UÇK-së NË APEL, SHIROKA PULA PRET GRUPIN PUNUES: KOHA PËR UNITETIN POLITIK E INSTITUCIONAL

EPOKA E RE **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 18 NËNTOR - Me ftesë të presidentes së Republikës së Kosovës, Justina Shiroka Pula, të mërkurën u mbajt takim me Grupin Punues për hartimin dhe harmonizimin e Strategjisë Shtetërore lidhur me procedurat e Apelit para Dhomave të Specializuara në Hagë, ndaj ish-krerëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.
Në këtë takim, Kryesuesi i Grupit Punues për hartimin e strategjisë për mbrojtjen e ish-krerëve të UÇK-së në Apel, Glauk Konjufca dhe anëtarët e Grupit e informuan presidenten Shiroka Pula për ecurinë e deritashme të punës.
Gjithashtu u diskutua edhe për mbarëvajtjen e punës me qëllim të koordinimit ndërinstitucional, të mbështetjes juridike, institucionale dhe diplomatike për procesin e apelit.
Presidentja Shiroka Pula, shprehu mbështetjen për Grupin Punues, me qëllim të bashkërendimit të veprimeve ndërinstitucionale dhe diplomatike për dokumentimin, mbrojtjen dhe afirmimin e së vërtetës historike të luftës çlirimtare të Kosovës dhe të rolit të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.
Për këtë takim, ka shkruar edhe ushtruesja e detyrës së kryetares së Partisë Demokratike të Kosovës, Vlora Çitaku.
Në një postim në rrjetet sociale pas takimit, Çitaku tha se e ka falënderuar Presidenten për mbështetjen e parezervë dhe gatishmërinë për të kontribuar në përpjekjen e përbashkët për mbrojtjen e çlirimtarëve. "Tani është koha që unitetin politik e institucional ta dëshmojmë me veprime dhe mbështetje konkrete për mbrojtjen e çlirimtarëve në apel", shkroi Çitaku.
Ajo riafirmoi përkushtimin për të qëndruar pranë çlirimtarëve në betejën për drejtësi dhe për ta mbrojtur me vendosmëri të vërtetën për luftën e drejtë të UÇK-së. "Deri në kthimin e tyre të lirë në atdhe!", përfundoi Çitaku.



Aplikimi për lejeqëndrim në Kosovë tashmë mund të bëhet online përmes e-Kosovës



PRISHTINË, 18 NËNTOR - Aplikimet për herë të parë për lejeqëndrim në Republikën e Kosovës tashmë mund të realizohen online, përmes platformës shtetërore e-Kosova.

Kështu ka bërë të ditur ministri i Punëve të Brendshme, Xhelal Sveçla, përmes një postimi, duke njoftuar për digjitalizimin e këtij shërbimi.

Sipas Sveçlës, ky ndryshim synon lehtësimin e procedurave administrative dhe krijimin e mundësive për një qasje më të shpejtë, më të thjeshtë dhe më efikase për shtetasit e huaj që aplikojnë për lejeqëndrim në Kosovë. Ai ka theksuar se aplikimi online mund të bëhet vetëm nga brenda territorit të Republikës së Kosovës, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

NGA MESAZHET MASHTRUESE TE HETIMI: SI I HETON POLICIA MASHTRIMET ONLINE?



PRISHTINË, 18 NËNTOR - Një SMS ju kërkon t'i përditësoni të dhënat bankare që të vazhdoni t'i përdorni shërbimet e bankës. Një tjetër ju njofton se keni një pako në pritje ose një gjobë trafiku për të paguar. Sipas Policisë së Kosovës, kërkesa për përditësimin e të dhënave bankare ka qenë forma më e shpeshtë e mashtrimit me SMS ndër rastet e raportuara nga qytetarët. "Një numër i konsiderueshëm i qytetarëve kanë rënë viktimë e këtyre mesazheve me përmbajtje mashtruese", thotë Fadil Abdyli, shef i hetimeve të krimeve kibernetike në Policinë e Kosovës, në një intervistë për Radion Evropa e Lirë. Ai nuk dha shifra për numrin e viktimave.

Këto mashtrime njihen si smishing. Mesazhi duket sikur vjen nga një institucion i besueshëm dhe mund ta drejtojë marrësin te një lidhje ku i kërkohen të dhëna, si numri i kartelës bankare ose kodi i saj i sigurisë. Kur mesazhi dërgohet në emër të Postës, kërkesa për të konfirmuar adresën e dorëzimit mund të shoqërohet me një kërkesë për të dhënat e kartelës. "Asnjë institucion serioz nuk të kërkon me mesazh numrin ose të dhënat e bankës", thotë Abdyli.

Sipas tij, një skemë e ngjashme përdoret edhe në platformat e shitblerjes online.

Dikush paraqitet si blerës dhe i kërkon shitësit numrin e kartelës dhe kodin e sigurisë, me arsyetimin se i duhen për ta paguar produktin. Mashtruesit mund t'i përdorin të dhënat e kartelës për të bërë pagesa në emër të viktimës dhe të dhënat personale për t'u paraqitur me identitetin e saj.

Çfarë i duhet Policisë për ta nisur hetimin?

Nëse dikush i ka dhënë të dhënat e kartelës përmes një lidhjeje të dyshimtë, Abdyli thotë se hapi i parë është ta njoftojë menjëherë bankën që ta bllokojë kartelën. Për ta raportuar rastin në Polici, ai këshillon ta ruajë mesazhin dhe pamjet e ekranit. "Duhet të kemi linkun, duhet të kemi datën dhe kohën, duhet të kemi përmbajtjen e mesazhit", thotë ai.

Këto të dhëna, shpjegon Abdyli, e ndihmojnë Policinë të përcaktojë si ka ndodhur mashtrimi dhe nëse ka bazë për ta nisur hetimin me autorizim të prokurorit. Hetimi mund të kërkojë bashkëpunim me bankat dhe me policitë e vendeve të tjera.

Autori mund të jetë në një shtet, viktima në një tjetër dhe infrastruktura e përdorur për mashtrim në një të tretë. Për shkak se në hetim mund të përfshihen edhe autoritete të huaja, Abdyli thotë se "nuk është një punë që mund të kryhet menjëherë".

I pyetur nëse pas mesazheve të raportuara së fundi qëndrojnë autorë nga Kosova apo nga jashtë, Abdyli nuk dha hollësi, duke iu referuar proceseve hetimore.

Ai tha se ka pasur raste kur paratë e humbura nuk janë kthyer. Shtoi se në trajtimin e këtyre rasteve, përveç Policisë, përfshihen edhe institucione të tjera.

Çfarë ndodh kur një profil anonim mbyllet pas kërcënimit?

Policia trajton edhe kanosje dhe ngacmime në rrjetet sociale. Kur një llogari mbyllet pas një kërcënimi dhe personi i kërcënuar nuk e ka ruajtur lidhjen e profilit, hetimi bëhet më i vështirë, thotë Abdyli. "Policia e Kosovës ka kontakte të drejtpërdrejta me platformat kryesore", thotë ai. Këto platforma operojnë nën juridiksione të tjera, por Policia mund t'u kërkojë të dhëna nëpërmjet kanaleve zyrtare në raste serioze, si kërcënimet për jetën.

Sipas Abdylit, platformat mund ta ndihmojnë Policinë të identifikojë personat që dyshohet se qëndrojnë pas këtyre profileve. I pyetur konkretisht për bashkëpunimin me Meta-n, ai foli për platformat në përgjithësi. Rastet e shpërndarjes së materialeve të abuzimit seksual të fëmijëve trajtohen kryesisht në nivel qendror për shkak të ndjeshmërisë së tyre dhe nevojës për bashkëpunim ndërkombëtar.

Abdyli thotë se Policia bashkëpunon me një platformë me bazë në Shtetet e Bashkuara, e cila "grumbullon informata ose raporte kur materialet me përmbajtje të abuzimit seksual të fëmijëve shpërndahen përmes internetit". Ai shpjegon se Policia merr raportime për raste kur shpërndarja ka ndodhur në Kosovë. Sipas tij, ky bashkëpunim e ka ndihmuar Policinë të identifikojë dhe të arrestojë persona të dyshuar.

I pyetur për gatishmërinë e Kosovës për t'u përballur me një sulm më të madh kibernetik, Abdyli e kufizoi përgjigjen te kapacitetet e Policisë. Ai thotë se Policia ka ekipe në rajonet policore dhe në nivel qendror për të hetuar veprat penale që kryhen përmes internetit.

Sipas tij, parandalimi kërkon bashkëpunim të vazhdueshëm me ekipin shtetëror për reagim ndaj incidenteve kibernetike, ofruesit e internetit dhe institucionet financiare. "A mund të themi se jemi të sigurt 100%? Natyrisht se nuk mund të themi", thotë Abdyli.

Shiroka Pula takon Daniel Serwerin, diskutojnë për zhvillimet në Kosovë dhe rajon



PRISHTINË, 18 NËNTOR - Presidentja e Republikës së Kosovës, Justina Shiroka Pula, priti në takim profesorin Daniel Serwer, ekspert i çështjeve të Ballkanit Perëndimor.

Gjatë takimit u diskutua për zhvillimet aktuale në Kosovë dhe rajon, sfidat e sigurisë dhe proceset politike në Ballkanin Perëndimor.

Presidentja Shiroka Pula theksoi rëndësinë e mbështetjes së vazhdueshme ndërkombëtare për Kosovën, si dhe të forcimit të partneritetit me Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Bashkëbiseduesit shkëmbyen pikëpamje edhe për perspektivën euroatlantike të Kosovës dhe zhvillimet në rajon.

Hoti pret në takim komandantin e KFOR-it, diskutojnë për situatën e sigurisë në Kosovë

PRISHTINË, 18 NËNTOR - Ushtruesi i detyrës së drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Kosovës, kolonel Fehmi Hoti, ka pritur të mërkurën në takim komandantin e KFOR-it, gjeneralmajorin Roberto Vergori.

Sipas njoftimit të Policisë së Kosovës, në takim, ku të dy zyrtarët ishin të shoqëruar nga bashkëpunëtorët e tyre, u diskutuan çështje të ndryshme që lidhen me situatën e sigurisë në Republikën e Kosovës.

Gjatë takimit u konfirmua vazhdimi i bashkëpunimit ndërmjet Policisë së Kosovës dhe KFOR-it, si dhe avancimi i shkëmbimit të informacioneve, me qëllim të ruajtjes së një ambienti të qetë dhe të sigurt për të gjithë qytetarët.

Po ashtu, temë e diskutimit ishin aktivitetet e përbashkëta të Policisë së Kosovës dhe KFOR-it, të cilat ndikojnë në situatën e sigurisë në tërë vendin.

Në fund, të dyja palët u pajtuan se vazhdimi i bashkëpunimit, mirëbesimit dhe realizimi i aktiviteteve të përbashkëta janë të rëndësishme për avancimin e mëtejmë të sigurisë së përgjithshme në Kosovë.



HAXHIU TAKON METSOLËN DHE EURODEPUTETËT NË BRUKSEL, KËRKON MBËSHTETJE PËR AVANCIMIN E KOSOVËS DREJT BE-së

BRUKSEL, 18 NËNTOR - Kryetarja e Kuvendit të Republikës së Kosovës, Albulena Haxhiu, gjatë vizitës zyrtare në Bruksel, takoi eurodeputetët Lukas Mandl, Matjaž Nemec, Thijs Reuten dhe Adnan Dibrani.

Gjatë takimeve, kryetarja Haxhiu theksoi se Kosova nuk kërkon trajtim të veçantë, por një proces të drejtë dhe vlerësim mbi bazën e meritave, me të njëjtat kritere që zbatohen për vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor.

Ajo i falënderoi eurodeputetët për angazhimin e tyre të vazhdueshëm për Kosovën, përfshirë reagimin lidhur me këngën në hapjen e Forumit të Zgjerimit, për të cilën Mandl ka parashtruar edhe një pyetje parlamentare.

Kryetarja Haxhiu bëri të ditur se gjatë takimeve u diskutua edhe për ligjet që Kuvendi po i shqyrton në kuadër të Agjendës së Reformave dhe Planit të Rritjes, si dhe për rëndësinë e miratimit të tyre në procesin e integrimit evropian.

Ajo tha se nga eurodeputetët kërkoi mbështetje që kërkesa e Kosovës për anëtarësim të shqyrtohet në Këshillin e BE-së, si dhe angazhim pranë pesë shteteve anëtare që ende nuk e kanë njohur Kosovën.

Ndërkaq, eurodeputeti Thijs Reuten, ish-raportues i Parlamentit Evropian për liberalizimin e vizave, e njoftoi për përpjekjet që ka bërë edhe në këtë drejtim, bëri të ditur kryetarja Haxhiu.



Haxhiu ka takuar edhe presidenten e Parlamentit Evropian, Roberta Metsola, në zyrën e saj në Bruksel, ku po merr pjesë në Konferencën Botërore për e-Parlamentin. "E falënderova për ftesën dhe për përkrahjen e vazhdueshme të Parlamentit Evropian për Kosovën. Vlerësova gjithashtu angazhimin e saj personal që zgjerimi i BE-së të mbetet në qendër të agjendës politike evropiane", theksoi Haxhiu.

Ajo rikujtoi se në dhjetor mbushen katër vjet që kur Kosova dorëzoi kërkesën për anëtarësim në Bashkimin Evropian. "Vendi ynë është plotësisht i përafruar me politikën e jashtme dhe të sigurisë së BE-së, ndërsa qytetarët tanë janë ndër mbështetësit më të mëdhenj të anëtarësimit në gjithë rajonin. Ata meritojnë të shohin përparim konkret në rrugën drejt BE-së. Prandaj, i kërkova presidentes Metsola të angazhohet që Këshilli i BE-së ta ftojë Komisionin Evropian të japë mendimin për kërkesën e Kosovës, siç ka kërkuar edhe vetë Parlamenti Evropian", theksoi ajo.

Haxhiu tha se Kuvendi po u jep përparësi ligjeve që lidhen me reformat evropiane.

Ajo theksoi se gjatë takimit me presidenten Metsola biseduan edhe për forcimin e bashkëpunimit me Parlamentin Evropian përmes Komisionit Parlamentar të Stabilizim-Asociimit dhe shkëmbimeve të drejtpërdrejta ndërmjet deputetëve dhe administratave të dy parlamenteve. "Kërkova gjithashtu mbështetjen e saj për anëtarësimin e Kuvendit të Kosovës në Unionin Ndërparlamentar (IPU), që është edhe bashkorganizator i kësaj konference.

Presidentja Metsola u zotua se do të ndihmojë në këtë drejtim. "Në fund, e ftova për një vizitë zyrtare në Republikën e Kosovës", tha kryetarja Haxhiu.

ÇITAKU PRITI NË TAKIM PËRSHËNDETËS AMBASADORIN MALAJ, VLERËSOI BASHKËPUNIMIN E TIJ NË FORCIMIN E MARRËDHËNIEVE KOSOVË - SHQIPËRI

PRISHTINË, 18 NËNTOR- Ushtruesja e detyrës së kryetares së Partisë Demokratike të Kosovës, Vlora Çitaku, së bashku me sekretarin për politika programore të PDK-së, Bajrush Xhemajli, priti në takim përshëndetës ambasadorin e Republikës së Shqipërisë në Kosovë, Petrit Malaj, me rastin e përfundimit të mandatit të tij.

Çitaku e falënderoi ambasadorin Malaj për bashkëpunimin e ngushtë dhe kontributin e tij në forcimin e marrëdhënieve vëllazërore ndërmjet Kosovës dhe Shqipërisë.



Ajo vlerësoi punën e ambasadorit Malaj gjatë mandatit në Kosovë dhe i uroi suksese në misionin e ri si ambasador i Shqipërisë në Maqedoninë e Veriut.

Ambasadori Malaj shprehu mirënjohjen e tij për bashkëpunimin me PDK-në dhe vlerësoi rolin e saj historik për Kosovën dhe shqiptarët.

Ai i uroi Çitakut punë të mbarë dhe suksese në përgjegjësinë e ushtrueses së detyrës së kryetares së PDK-së.

Çitaku dhe Malaj diskutuan për të ardhmen e përbashkët euroatlantike, duke vlerësuar përparimin e Shqipërisë drejt anëtarësimit në Bashkimin Evropian dhe duke nënvizuar nevojën që edhe Kosova të shënojë hapa konkretë drejt realizimit të këtij vizioni shtetëror.

Gjatë takimit u shpreh solidaritet me çlirimtarët në Hagë dhe u theksua rëndësia e një procesi të drejtë e të paanshëm.

Në takim u nënvizua se mbrojtja e së vërtetës për luftën e UÇK-së, e historisë dhe e së ardhmes së Kosovës është mision i përbashkët i të gjithë shqiptarëve.

Çitaku riafirmoi se PDK-ja do të jetë pranë çlirimtarëve në çdo hap të procesit të apelit dhe shprehu besimin se kjo fazë do të çojë në rrëzimin e aktgjykimit të shkallës së parë dhe në lirimin e plotë të tyre.

Arben Mustafa: Mosrespektimi i afateve ligjore nga KPMM-ja krijon pasiguri juridike për investitorët

PRISHTINË, 18 NËNTOR - Kryetari i Komisionit për Ekonomi, deputeti Arben Mustafa, ka ngritur shqetësimin për mosrespektimin e afateve ligjore nga Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale (KPMM) në trajtimin e aplikimeve të investitorëve për licenca të hulumtimit të mineraleve.

Mustafa ka bërë të ditur se kjo çështje është diskutuar në Komisionin për Ekonomi, gjatë shqyrtimit të Raportit Vjetor të KPMM-së.

Sipas tij, mosrespektimi i afateve ligjore krijon pasiguri juridike, dëmton klimën e investimeve dhe hap rrugë për praktika të arbitraritetit institucional.

Ai ka theksuar se Komisioni për Ekonomi do të vazhdojë mbikëqyrjen institucionale, duke kërkuar llogaridhënie për zbatimin e ligjit dhe trajtim të barabartë për të gjithë investitorët.



SIGURIA ENERGJETIKE E KOSOVËS NUK MUND TË NDËRTOHET VETËM ME VENDIME POLITIKE



Safet GËRXHALIU

Kosova nuk mund ta ndërtojë sigurinë energjetike vetëm duke ndaluar tregtinë me një shtet apo me kompani të caktuara. Ajo duhet ta ndërtojë atë duke prodhuar më shumë energji, duke investuar në teknologji, duke diversifikuar furnizimin dhe duke krijuar një treg konkurrues e të qëndrueshëm.

Ndalimi i tregtimit me kompanitë serbe mund të jetë një instrument i politikës ekonomike dhe energjetike, por ai nuk e zgjidh vetvetiu deficitin e prodhimit vendor.

Kosova duhet të sigurojë rrugë alternative të furnizimit, të forcojë kapacitetet ndërkufitare me vendet e tjera dhe të mos lejojë që kufizimet politike dhe tregtare të kthehen në krizë të përsëritur për qytetarët dhe bizneset.

Për këtë arsye, paralelisht me vendimin për kompanitë serbe, Qeveria duhet të shpjegojë se si do të garantohet furnizimi gjatë periudhave të kërkesës së lartë, sidomos kur njësitë prodhuese vendore janë në remont ose jashtë funksionit.

Edhe masat emergjente të miratuara nga Qeveria për furnizimin me energji, për një periudhë 60-ditore, si dhe obligimi publik i KEK-ut për sigurimin e kapaciteteve ndërkufitare për muajin dhjetor, duhet të shoqërohen me llogaridhënie dhe transparencë mbi kostot dhe rezultatet.

Kosova ka nevojë për strategji afatgjatë, jo vetëm për reagime emergjente

Dalja nga kjo gjendje kërkon një program kombëtar me financim, afate dhe përgjegjësi publike si rehabilitimin dhe modernizimin e koordinuar të njësive ekzistuese, përcaktimin e së ardhmes së termocentralit "Kosova A", përzgjedhjen dhe ndërtimin e kapaciteteve të reja prodhuese, përshpejtimin e investimeve private në energjinë diellore dhe atë të erës, zhvillimin e baterive dhe sistemeve të ruajtjes së energjisë, përforcimin e rrjetit dhe kapaciteteve të interkoneksionit me vendet e rajonit, diversifikimin e burimeve të furnizimit dhe shqyrtimin e mundësive të reja teknologjike etj.

Konsensusi politik duhet të garantojë vazhdimësinë e investimeve, sepse energjia nuk mund të trajtohet vetëm si çështje e një mandati qeverisës. Pasuria e madhe nëntokësore, potenciali i diellit dhe i erës dhe pozita gjeografike e Kosovës duhet të shndërrohen në avantazh ekonomik.

Përndryshe, çdo krizë e re energjetike do të vazhdojë të na kujtojë se problemi nuk është mungesa e resurseve, por mungesa e investimeve në kohë, e planifikimit afatgjatë dhe e vendimeve strategjike.

Energjia nuk është vetëm çështje teknike. Ajo është çështje e sigurisë kombëtare, e zhvillimit ekonomik dhe e mirëqenies së qytetarëve.

KU SHKUAN 13.4 MILIARDË EURO TË BUXHETIT TË KOSOVËS? RAPORTI I GAP-it ZBULON SE CILAT FUSHA MORËN MË SË SHUMTI

Prishtinë, 18 nëntor - Rreth 13.4 miliardë euro, apo 87% e shpenzimeve buxhetore të Kosovës gjatë periudhës 2021 - 2025, kanë kontribuar në realizimin e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ).

Megjithatë, pjesa më e madhe e këtyre mjeteve është përqendruar në vetëm pesë fusha: uljen e varfërisë, forcimin e institucioneve, arsimin, infrastrukturën dhe shëndetësinë.

Këto janë ndër gjetjet kryesore të raportit "Ndërlidhja e buxhetit të Kosovës me Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (2021 - 2025)", të prezantuar nga Instituti GAP në një tryezë diskutimi, me mbështetjen e Zyrës së Koordinatorit për Zhvillim të Kombeve të Bashkuara.

Drejtori Ekzekutiv i Institutit GAP, Blendi Hasaj, tha se raporti paraqet analizën e parë gjithëpërfshirëse të përputhshmërisë së shpenzimeve publike të Kosovës me 17 Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm.

Koordinatorja e Hulumtimeve në Institutin GAP, Rrona Zhuri, theksoi se, pavarësisht kontributit të lartë të buxhetit në këto objektiva, shpërndarja e mjeteve mbetet e pabalancuar.

Ajo rekomandoi integrimin më të mirë të objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm në planifikimin buxhetor, rritjen e financimit për fushat e nënfinancuara dhe përmirësimin e targetimit të transfereve sociale.

Ndërkaq, Koordinatori i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim në Kosovë, Stephen O'Malley, theksoi se buxheti është pasqyrimi më i qartë i prioriteteve të një qeverie.

Ai rikujtoi se Kosova kishte shprehur përkushtimin institucional ndaj Objektivave të



Zhvillimit të Qëndrueshëm përmes një rezolute të Kuvendit në vitin 2018.

Sipas tij, raporti mundëson vlerësimin nëse investimet publike po kontribuojnë në përmbushjen e zotimeve për zhvillim të qëndrueshëm.

Zëvendësministri i Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Driton Hyseni, kërkoi që në analiza të tilla të përfshihen edhe donacionet dhe fondet ndërkombëtare.

Ai përmendi financimin prej 25 milionë eurosh nga Banka Botërore për sektorin e ujërave dhe 25 milionë euro të tjera nga Banka Zhvillimore e Këshillit të Evropës për përmirësimin e kushteve të banimit social.

Në anën tjetër, zyrtarja e lartë në Zyrën për Planifikim Strategjik në Qeverinë e Kosovës, Armenda Shala, bëri të ditur se Strategjia Kombëtare për Zhvillim 2030 përmban 143 indikatorë për matjen e progresit, prej të cilëve rreth 80% janë në përputhje me objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm.

Shefja e Zyrës së UN Women në Kosovë, Vlora Nushi-Tuzi, theksoi nevojën që barazia gjinore të integrohet në të gjitha fushat e buxhetit, në mënyrë që të adresohen pabarazitë strukturore.

Ajo përmendi kujdesin e papaguar, mungesën e qasjes në transport dhe shërbimet e kujdesit si disa nga pengesat që kufizojnë pjesëmarrjen e grave në tregun e punës.

Sipas saj, buxhetimi i përgjegjshëm gjinor është i rëndësishëm për shpërndarjen e barabartë të fondeve publike dhe monitorimin e shpenzimeve.

Në diskutim morën pjesë përfaqësues të institucioneve qendrore, organizatave ndër-kombëtare dhe vendore.

MINISTRJA KUSARI-LILA NË FORUMIN KOSOVË – POLONI: SYNOJMË MË SHUMË PRODUKTE KOSOVARE NË TREGUN POLAK

Prishtinë, 18 nëntor - Ministrja e Industrisë, Ndërmarrësisë, Tregtisë dhe Inovacionit, Mimoza Kusari-Lila, mori pjesë në hapjen e edicionit të tretë të Forumit Ekonomik Kosovë - Poloni, i cili po mbahet në Prishtinë, me pjesëmarrjen e përfaqësuesve institucionalë dhe komunitetit të biznesit nga të dyja vendet.

Forumi synon të krijojë partneritete të reja dhe të nxisë investimet në sektorët me potencial për zhvillim, përfshirë ekonominë digjitale, mbrojtjen dhe sigurinë kibernetike, prodhimin e avancuar, infrastrukturën dhe energjinë.

Në fjalën e saj para pjesëmarrësve, ministrja Kusari-Lila theksoi rëndësinë e rritjes së investimeve polake në Kosovë, zgjerimit të pranisë së produkteve kosovare në tregun polak dhe krijimit të ndërmarrjeve të përbashkëta, me fokus në inovacion, teknologji, prodhim dhe shërbime.

Ajo tha se një nga synimet e Qeverisë dhe MINTI-t është orientimi i ekonomisë drejt prodhimit dhe eksportit, duke përmendur edhe rritjen e bashkëpunimit tregtar me Poloninë. Sipas saj, synohet që përveç rritjes së importeve dhe partneriteteve nga Polonia, të shtohet edhe prania e produkteve kosovare në tregun polak, në mënyrë që shkëmbimet tregtare të jenë më të balancuara dhe me përfitime të ndërsjella.

Një tjetër çështje e trajtuar ishte integrimi i prodhuesve kosovarë në tregun e Bashkimit Evropian përmes zgjerimit të mundësive për ofrimin e shërbimeve të montimit dhe instalimit. Në këtë drejtim, ministrja bëri të ditur se po punohet për marrëveshje bilaterale për leje të përkohshme pune, të cilat do t'u mundësonin kompanive kosovare t'i shoqërojnë produktet e tyre me shërbime drejtpërdrejt te klientët në tregjet evropiane.

Forumi është organizuar nga MINTI, në bashkëpunim me Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës dhe Konsullatën e Përgjithshme të Republikës së Kosovës në Poloni.

Pas edicioneve të mëparshme në



Prishtinë më 2022 dhe në Varshavë më 2024, këtë vit forumi rikthehet në kryeqytetin e Kosovës.


Në kuadër të forumit janë zhvilluar takime të drejtpërdrejta B2B dhe B2G ndërmjet bizneseve dhe institucioneve të të dy vendeve, me synimin që kontaktet e krijuara të konkretizohen në kontrata, investime dhe bashkëpunime të reja ekonomike.

UDHËHEQËSI HYDAJET HYSENI E VIZATOI VETEN KUR SERBIA IA MOHOI SHIKIMIN NË PASQYRE NË BURGUN QENDROR NË BEOGRAD



Ismet SYLEJMANI





Autokujtim gri (1983)

Udhëheqësi i madh e ilegal i famshëm i popullit, Atdheut dhe Kombit Hydajet Hyseni, edhe me autoportretin e Tij, ka dëshmuar se ishte dhe mbetet njëri prej revolucionarve më të mëdhenj shqiptar, i cili në mes të torturës çnjerëzore dhe vetmisë absolute, dëshmoi qëndresë biblike dhe ideali i lirisë dhe i çlirimit te Kosovës nga Serbia pushtuese e bëri të mbijetuar heroik e triumfator legjendar!

Duke qenë se unë jam njëri nga vazhduesit e veprimtarisë së Tij atdhetare, politiko-patriotike dhe kombëtare ilegale, dhe pjesë aktive e progresive e përpjekjeve për ta çuar përpara idealin dhe rrugëtimin e Tij historik, kam të drejtën e madhe dhe të padiskutueshme ta pyes foton e Tij, kush je Ti, sepse edhe unë kamë dhënë kontributin tim modest në këtë rrugëtim, dhe me lejohen pyetje të tilla!

Në një periudhë të caktuar, kam pasur përgjegjësi dhe detyra drejtuese në kuadër të veprimtarisë ilegale, kam qenë Anëtar i Komitetit Drejtues në Lëvizjen Popullore të Kosovës, në të cilën jam angazhuar me përkushtim, me përgjegjësi direkte dhe vendosmëri absolute për realizimin e aspiratave tona kombëtare e atdhetare, por edhe gjatë luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, kam qenë Anëtar i Shtabit të Zonës Operative të Karadakut dhe Zëdhënës i Zonës!

Prandaj, duke u nisur nga kjo përvojë, nga përgjegjësitë që kam bartur dhe nga përkushtimi im ndaj çështjes kombëtare shqiptare, e ndiej obligim moral e atdhetar që të shpreh qëndrimin tim, duke vlerësuar drejt historinë, kontributin dhe sakrificën e udhëheqësve tanë, të cilët me tërë qenien iu përkushtuan luftës për liri dhe çlirim të Kosovës nga dhuna dhe terrori gjenocidal i Serbisë pushtuese!

Nisur nga sa dëshmova se kush jam, marr të drejtën të të pyes jo vetëm për vetën time por edhe për të tjerët dhe kam të drejtë ta dij,

Kush je Ti,

Që në errësirën e qelisë, aty ku njeriu përballet me vetminë, me vuajtjen dhe me kufijtë e qëndresës së vet, kërkon ta shohësh fytyrën Tënde, jo për ta admiruar, jo për t'u dukur i bukur, jo për t'u knaqur duke e parë, por për ta njohur sërish pas një kohe të gjatë izolimi, terrori e trajtimi çnjerëzor nga kriminelët dhe UDB-ashët e zinj serb dhe shqiptar?!

Kush je Ti,

Që të kanë mbyllur pas dyerve të hekurta, e të kanë lidhur këmbë e duar, që të kanë ndarë nga familja, nga shokët e idealit, nga veprimtaria politike patriotike atdhetare dhe nga jeta e përditshme, por që vazhdon ta ruash lidhjen me botën e mendimit, me ndërgjegjen dhe me bindjet për të cilat je burgosur dhe torturohesh pmëshirshëm?!

Kush je Ti,

Që në një qeli të krijuar enkas për ta nënshtruar e shkatrruar njeriun kryengritës, Ti gjen forcën të përballesh stoikisht me pamjen Tënde të tmerrshme, të ndryshuar nga vuajtjet dhe të rrahurat shtazarake, dhe ta hedhësh atë në letër?!

Çfarë fuqie morale, çfarë dashurie ndaj të parëve duhet të keshë, çfarë përjetimi mbinjerëzor, çfarë nevoje shpirtërore dhe çfarë force krijuese mund të ta shtyjë një të burgosur politik heroik, të rraskapitur e të cfilitur nga torturat dhe nga izolimi serbo-jugosllav, dhe të bëjë përpjekje heroike ta vizatojë vetveten?!

Ti je Udhëheqësi Hydajet Hyseni,

Ti je Sekretari Organizativ i Grupit Marksist-Leninist të Kosovës!

Ti je Udhëheqësi Hydajet Hyseni,

Kryeveprimtar politik dhe revolucionar legjendar shqiptar, intelektual dhe njëri prej përfaqësuesve më në zë të brezit të Tënd, që e lidhe jetën Tënde me luftën dhe përpjekjet e popullit shqiptar për të drejtat kombëtare, për barazi, për çlirim dhe për lirinë e shqiptarëve të Kosovës dhe Viseve të saja nën Ish-Jugosllavi!

Udhëheqësi Hydajet Hyseni, ishte dhe mbeti njëri nga Ata që nuk pranoi të mbetej vëzhgues pasiv dhe i vdekur për së gjalli i realitetit politik të kohës, por u angazhua në mënyrë aktive për ndryshimin e realitetit antishqiptar, duke marrë mbi supe rreziqet dhe pasojat që sillte veprimtaria e organizuar ilegale atdhetare, politiko-patriotike kundër pushtetit jugosllavo – serb!

Udhëheqësi Hydajet Hyseni i takoi atij brezi për të cilin çështja shqiptare e Kosovës nuk ishte vetëm temë diskutimi politik dhe analize, por një problem historik, kombëtar dhe shoqëror që kërkonte zgjidhje me angazhim direkt, organizim përmanent dhe veprim aktiv!

Udhëheqësi Hydajet Hyseni zgjodhi veprimtarinë politike ilegale, organizimin revolucionar dhe angazhimin atdhetar, duke e ditur se një veprimtari e tillë, në rrethanat e asaj kohe, mund të përfundonte me vrasje, arrestim, burgim dhe pasoja të rënda për jetën personale!

Dhe ndaj personalitetit të Udhëheqësit Hydajet Hyseni, ato pasoja nuk mbetën vetëm mundësi teorike!

Fatkeqësisht ato u bënë pjesë e jetës së Tij!

Arrestimi, hetuesia, torturat, izolimi dhe burgu i rëndë politik, e shkëputën për vite të tëra nga jeta e lirë, por jo edhe nga historia e luftës dhe përpjekjeve të popullit shqiptar, të cilave ua kishte kushtuar veprimtarinë e vet atdhetare dhe revolucionare!

Në qelinë e Burgut Qendror të Beogradit- CZ, ku u mbajt në izolim gjatë hetuesisë, përballja nuk ishte më me kundërshtarë politikë në një debat idesh e konceptesh!

Përballja e Udhëheqësit Hydajet Hyseni zhvillohej në kushtet e pabarazisë totale njerëzore, ekstreme midis një të burgosuri të lidhur këmbë e duar me zingjir dhe aparatit shtetëror serb të terrorit dhe dhunës permanente mbi shqiptarët!

Atdhetarët dhe patriotët shqiptar në përgjithësi, udhëheqësit dhe njëri ndërt ta Kryeudhëheqësi Hydajet Hyseni në veçanti, ishin të privuar nga liria themelore, nga komunikimi i zakonshëm, nga kontakti me njerëzit e afërt dhe nga mundësitë më elementare për të vendosur mbi jetën e tyre!


Vetmia e zgjatur dhe e shoqëruar me torturë çnjerëzore për të burgosurit politik shqiptar të Kosovës dhe Viseve të saja, nuk ishte thjesht mungesë shoqërie!

Vetmia e thellë në kushte të rrahjes dhe torturës çnjerëzore, ishte një përvojë e rëndë psikologjike, e cila, e shoqëruar me pasigurinë për të ardhmen, mund ta vinte njeriun përballë sprovave më të vështira fizike e shpirtërore!

Në kushtet e pamëshirshme të krijuara në burgjet jugosllave

→

nga UDB-a serbe, edhe gjërat që jashtë burgut duken të parëndësishme, në burg marrën një kuptim të jashtëzakonshëm!
Një rreze dielli që dëpërtonte nëpër grilat e vetmisë së errët të burgut!
Një pikë ujë në dysheme!
Një pamje e fytyrës, të pa shikuar nga ditë, javë e muaj të tërë!
Një mundësi për ta njohur sërish vetveten!
Sipas rrëfimit për krijimin e autoportretit, Udhëheqësi Hydajet Hyseni, gjatë qëndrimit në qeli, nuk i lejohej të kishte pasqyrë!
Pas një periudhe të gjatë izolimi në Burgun Qendror të Kryeqytetit të Serbisë e të Jugosllavisë Beogradit, një rreze dielli, në kontakt me pak ujë në dyshemenë e qelisë, i krijoi mundësinë ta shihte fytyrën e Tij të dërmuar, të deformuar dhe të tharë e të terur nga torturat shtazarake!
Në një rrethanë të pazakontë, por thellësisht domethënëse, Udhëheqësi Hydajet Hyseni e merr lapsin e thjeshtë dhe e vizaton vetveten!
Ajo që në jetën e lirë të çdo njeriu do të mund të realizohej me një shikim të thjeshtë e të zakonshëm në një pasqyrë, në burg ishte shëndërruar në një përjetim të rrallë e të thellë!
Udhëheqësi Hydajet Hyseni në mënyrë të turbullt e kishte parë fytyrën e vet në ujë, pas një kohe të gjatë, ndonëse me vështirësi, por arrinte të dallonte ndryshimet e dhimbshme që i kishin shkaktuar vuajtjet ekstreme në burg dhe torturat sadiste që i ishin bërë, dhe bënte përpjekje ta ruante atë pamje të çastit në një vizatim të rrallë që do të mbetej historik!
Te kjo pamje tronditëse, zë fill një nga dëshmitë më të veçanta të përvojës së Udhëheqësit Hydajet Hyseni, si i burgosur politik, autoportreti i krijuar në qeli të Burgut Qendror në Beograd – CZ, më 1983!
Atelea artistike e Udhëheqësit Hydajet Hyseni, në qelinë e burgut, nuk ishte në një mjedis të përshtatshëm artistik as modern europian apo amerikan, sikur që nuk ishte as në kushte të zakonshme krijimtarie artistike, por ishte në Qelinë e Burgut të Sigurisë së Lartë të Burgut Qendror të Beogradit – CZ, në një hapësirë mesjetare ku mungonin edhe liritë më elementare njerëzore!
Në mes tjerash, ky është thelbi i jashtëzakonshëm i veprës artistike të autoportretit në kushte të tmerrshme të qëndrimit në vetminë e thellë të Udhëheqësit Hydajet Hyseni në CZ!
Udhëheqësi Hydajet Hyseni, është nëri nga Ata shqiptar të rrallë, ndaj të cilit ishte ushtruar dhunë dhe terror i paparë, intensiv dhe i padëgjuar, të cilit i ishte kufizuar në mënyrë drrastike e të rëndë jeta e lirë, megjithatë Ai kishte arritur të gjente një mënyrë për ta parë dhe për ta vizatuar vetveten!
Veprimi i Udhëheqësit Hydajet Hyseni, ishte veprim i madh personal heroik, ishte veprim i lindur në rrethana të pazakonta njerëzore, ishte veprim i imponuar i dalur nga izolimi total dhe nga nevoja ekstreme njerëzore për ta parë dhe për të ruajtur lidhjen me vetveten!
Si shokë e bashkëveprimtarë vuajmë pse nuk mund të dijmë me saktësi precize, çdo mendim e çdo ndjenjë që e ka shoqëruar Udhëheqësin Hydajet Hyseni gjatë krijimit të autoportretit të Tij të famshëm në vetminë e zezë në Burgun Qendror në Beograd!
Udhëheqësi Hydajet Hyseni, dëshmon para historisë dhe para artistëve profesionist e revolucionarë, se ta vizatosh fytyrën Tënde pasi të është mohuar për një kohë të gjatë mundësia për ta parë fytyrën në pasqyrë, nuk është një veprim i thjeshtë e i zakonshëm, por është e jashtëzakonshme!
Autoportreti i Udhëheqësit Hydajet Hyseni i krijuar në burg në pasqyrën prej uji, fiton një domethënie që shkon përtej historisë personale të autorit!
Udhëheqësi Hydajet Hyseni, me autoportretin e realizuar në vetminë ekstreme të Burgut Qendror në Beograd në vitin 1983, na dëshmon se përpjekjet dhe lufta për liri nuk zhvillohen vetëm në tubime, në demonstrata, në mitingje të mëdha popullore sikur ai kur mbajti fjalimin e Tij historik me 1 Prill 1981 në Prishtinë, e në organizata politike ilegale atdhetare e patriotike, apo në fushëbeteja luftërash të armatosura çlirimtare, sikur ato kur zhvilloi betejat UÇK-ja titanike!
Fakti që një njeri i izoluar në Burgun e Sigurisë së Lartë, në Burgun Qendror në Kryeqytetin e Serbisë pushtuese në Beograd, i privuar nga pasqyra dhe i sprovuar barbarisht nga torturat, arriti të krijonte autoportretin e vet historik, ka domethënie të mjaftueshme njerëzore dhe historike, por popullin, Atdheun dhe Kombin shqiptar!
Autoportreti meriton dhe duhet të ruhet jo vetëm në muze kombëtar e shtetëror por edhe në muze ndërkombëtar, të dokumentohet dhe të trajtohet me seriozitet, sepse përfaqëson një përvojë të pashembullt individuale që lidhet drejtpërdrejtë me historinë dhe vuajtjet e të të burgosurve politikë shqiptarë!
Dhe pikërisht këtu, pyetja e fillimit merr një kuptim më të plotë, edhe më të madh!
KUSH ËSHTË KY, QË E KA VIZATUAR VETEN NË ERRËSIRËN E QELISË NË BURGUN QENDROR NË BEOGRAD NË VITIN 1983?
Ky është Udhëheqësi lavdimadh e ilegali i famshëm Hydajet Hyseni, veprimtar revolucionar shqiptar, që përndjekja politike e çoi nga angazhimi intenziv atdhetar në hetuesi dhe në burgun pushtues jugosllavo-serb!



Autokujtim gri (1983)

Ky është Udhëheqësi Hydajet Hyseni i larguar nga jeta e lirë, i cili u përball me pamjen e fytyres së vet në kushte që tregojnë se deri ku shkonte poshtërimi i të burgosurit politik shqiptar të Kosovës dhe Viseve shqiptare në ish-Jugosllavi, dhe sa domethënëse bëhej edhe një e drejtë e zakonshme njerëzore, sikur është pasqyra!
Udhëheqësi Hydajet Hyseni është pjesë e një brezi të veprimtarëve shqiptarë, jeta e të cilëve u ndikua thellësisht nga përballja me pushtetin jugosllavo-serb dhe nga përpjekjet e tyre mbinjerëzore, për të ndryshuar pozitën politike e kombëtare të popullit shqiptar të Kosovës dhe Viseve të saja!
Autoportreti i Tij, është një dëshmi e madhe historike!
Autoportreti i Udhëheqësit Hydajet Hyseni, nuk është thjesht pamja e një fytyre të vizatuar të të një të burgosuri politik shqiptar!
Autoportreti i Udhëheqësit Hydajet Hyseni, është kujtimi artistik i një njeriu që e pa veten në kushte të pazakonta normale njerëzore, pas një periudhe të gjatë vuajtjesh, torturash e denimesh e poshtrimesh të pafundme!
Autoportreti i Udhëheqësit Hydajet Hyseni është një krijim që i përket një kohe të rëndë të vuajtjeve ekstreme dhe që duhet lexuar duke e shikuar me ndjeshmëri njerëzore e përgjegjësi të thellë historike!
Autoportreti i Udhëheqësit Hydajet Hyseni është një vepër artistike revolucionare që na kujton se pas çdo emri të njohur të historisë tonë politike qëndron jeta e rëndë reale, me vuajtje, me përjetime dhe me pasoja që nuk mund të përmblidhen vetëm me tituj e me vlerësime akademike e gazetareske!
Historia dëshmon se Udhëheqësi Hydajet Hyseni, në atë qeli të zezë pis, nuk ka vizatuar vetëm një figurë e personazh madhor të historisë kombëtare!
Por në radhe të parë ka vizatuar edhe vetveten!
Jeta e bujshme dhe veprimtaria revolucionare e Udhëheqësit Hydajet Hyseni, bëjnë që sot ky autoportret të shihet, jo vetëm si histori personale, por edhe si pjesë e historisë së qëndresës politike të shqiptarëve të Kosovës dhe Viseve të saja në ish-Jugosllavi!
Autoportreti i Udhëheqësit Hydajet Hyseni dëshmon se një çast i një momenti në vetminë e tmerrshme të burgut antishqiptar ne Beograd, dëshmon dhe na ndihmon që sot ta kuptojmë më mirë përmasën njerëzore të burgut politik çnjerzor ku vuante shqptari e ilegali më i madh i shqiptarëve në ish-Jugosllavi!
Prandaj, përpara autoportretit historik të Udhëheqësit Hydajet Hyseni, pyetja nuk është vetëm se kush ishte njeriu që e vizatoi veten në errësirën e qelisë duke e shfrytëzuar ujin si pasqyrë!
Por pyetja është edhe se çfarë ju mëson dhe çfarë ju transmeton brezave të ardhshëm të shqiptarëve të rinj ajo përvojë për njeriun e çliruar nga dhuna e shtypja serbe, për lirinë e munguar, për qëndresën heroike dhe për përgjegjësinë absolute ndaj historisë kombëtare!
Dhe përgjigjja gjendet te vetë akti i krijimit të një njeriu të lidhur këmbë e duar, të cilit i ishte mohuar në mënyrë kategorike pasqyra, dhe gjeti mundësinë gjeniale ta shihte dhe ta vizatonte fytyrën e vet!
Udhëheqësi Hydajet Hyseni njëri prej revolucionarëve të mëdhenj shqiptar, i cili kishte njohur torturat më mostruoze dhe izolimin antinjerëzor, na e la një dëshmi të vetvetes në rrethanat më të rënda të jetës së Tij!


Prishtinë, 17 Nëntor 2026!



sport



Xhaka, mungesa e madhe e Sunderlandit ndaj Aston Villas



SUNDERLAND, 18 NËNTOR - Sunderlandi do të jetë pa kapitenin Granit Xhaka në ndeshjen kampionale të këtij vikendi kundër Aston Villas, kanë njoftuar mediat britanike. Ndeshja Aston Villa - Sunderland do të zhvillohet të shtunën, nga ora 16:00, dhe i takon xhiros së 11-të në Premierligën e Anglisë. Xhaka do t'i mungojë Sunderlandit për shkak të lëndimit që e pësoi në duelin e fundit kundër Chelseat. Për të njëjtën arsye, ai nuk është grumbulluar as nga Zvicra për ndeshjet e Ligës së Kombeve. Mungesa e Xhakës pritet të zgjasë më shumë sesa ishte menduar fillimisht, kur mesfushori u largua nga fusha në minutën e katërt të ndeshjes për shkak të një problemi muskulor. Te Sunderlandi ende nuk kanë konfirmuar datën e rikthimit të tij, ndërsa raportohet se ka gjasa që të mos paraqitet fare gjatë këtij muaji për ekipin e tij. Mesfushori 34-vjeçar, në 14 paraqitje këtë sezon, ka dhënë një asistim për Sunderlandin, ekip me të cilin ka kontratë deri në vitin 2028.

KOSOVA E MBYLL EDICIONIN E PESTË TË LIGËS SË KOMBEVE, MBETET NË LIGËN B



DUBLIN, 18 NËNTOR - Kombëtarja e Kosovës e ka mbyllur edicionin e pestë të Ligës së Kombeve me humbje 3:0 nga Irlanda, në ndeshjen e zhvilluar të martën mbrëma në Dublin. Momenti vendimtar i ndeshjes ka ndodhur në minutën e 26-të, kur Kreshnik Hajrizi e ka ndalur topin me dorë në vijën e portës, duke shkaktuar penallti dhe duke u ndëshkuar me karton të kuq. Nga pika e bardhë, Troy Parrott ka qenë i saktë në minutën e 28-të, duke i dhënë epërsinë Irlandës.

Pavarësisht disavantazhit numerik, "Dardanët" janë përpjekur të qëndrojnë në lojë, por Irlanda e ka shfrytëzuar epërsinë e një lojtari më shumë. Në minutën e 50-të, pas një penalltie të shkaktuar nga portieri Aro Muric, Parrott ka realizuar sërish për 2:0.

Rezultatin përfundimtar 3:0 e ka vulosur Jack Moylan në minutën e 75-të, me një goditje të saktë me kokë. Kosova e ka nisur ndeshjen me qasje sulmuese, duke krijuar rrezik përmes Lindon Emërllahut dhe Vedat Muriqit, por përjashtimi i Hajrizit e ka ndryshuar rrjedhën e takimit. Me këtë rezultat, Kosova e ka përfunduar Grupin B3 në pozitën e tretë me gjashtë pikë dhe e ka siguruar qëndrimin në Ligën B edhe për edicionin e ardhshëm të Ligës së Kombeve. Austria e ka fituar grupin me 12 pikë, Irlanda e ka përfunduar në vendin e dytë me tetë, Kosova në vendin e tretë me gjashtë, ndërsa Izraeli ka mbetur i fundit me katër pikë. Kosova do të jetë në vazon e tretë për shortin e kualifikimeve, i cili do të tërhiqet më 6 dhjetor.

FIFA publikon renglistën, Kosova bie për dy pozita

Pas ndeshjeve të këtij muaji në Ligën e Kombeve, FIFA ka publikuar renglistën e re, në të cilën Kombëtarja e Kosovës ka pësuar rënie. Kosova i ka zhvilluar dy ndeshjet e fundit të edicionit të pestë të Ligës së Kombeve, duke marrë vetëm një pikë dhe duke e përfunduar garën në vendin e tretë në grupin B3.

Në renglistën e re të FIFA-s, Kosova renditet në pozitën e 78-të, me 1322 pikë, duke u pozicionuar pas Malit të Zi dhe Izraelit. Krahasuar me renglistën e kaluar, Kosova ka rënë për dy pozita, ndërsa shkak për këtë janë bërë rezultatet e fundit në Ligën e Kombeve. Ndërkohë, Kombëtarja e Shqipërisë është ngjitur për një pozitë dhe tani renditet në vendin e 65-të, me 1388 pikë. Shqipëria e ka fituar grupin C1 të Ligës së Kombeve, duke siguruar promovimin në Ligën B për sezonin 2028/29 të kësaj gare. Sa i përket kreut të renglistës, atë e mban Spanja, e ndjekur nga Argjentina, Franca, Anglia dhe Maroku.


VALENCIA INSISTON PËR MURIQIN, FENERBAHÇE MUND TA SHESË



STAMBOLL, 18 NËNTOR - Valencia nuk e ka ndërmend të heqë dorë nga sulmuesi i Kombëtares së Kosovës, Vedat Muriqi. Skuadra spanjolle po dëshiron me çdo kusht transferimin e Muriqit në afatin kalimtar të janarit. Sipas mediave turke, sulmuesi 32-vjeçar mund të largohet nga Fenerbahçe pas vetëm gjashtë muajsh. Valencia e sheh Muriqin si përforcimin e duhur për repartin ofensiv, ndërsa te Fenerbahçe kanë nisur diskutimet me trajnerin e ri, Emre Belozoglu, për mundësinë e largimit të kapitenit të Kosovës. Mbetet të shihet se cili do të jetë vendimi i trajnerit Belozoglu, pasi Valencia është e gatshme të bëjë të pamundurën për të siguruar shërbimet e Muriqit, pa vendosur kufi për shumën që do të ofrojë për kartonin e tij.

Muriqi, para fillimit të këtij sezoni, u rikthye te Fenerbahçe nga Mallorca për 15 milionë euro dhe ka kontratë deri në vitin 2029. Në 18 paraqitje për ekipin turk, ai ka shënuar 11 gola dhe ka dhënë dy asistime.

Guler rinovon kontratën me Real Madridin deri në vitin 2032



Madrid, 18 nëntor - Mesfushori turk, Arda Guler, do të vazhdojë të jetë pjesë e Real Madridit edhe për një periudhë të gjatë. Guler ka rinovuar kontratën me klubin spanjoll, duke u lidhur me të deri më 30 qershor të vitit 2032, ka njoftuar Real Madridi të mërkurën. Paraqitjet e mira të mesfushorit 21-vjeçar kanë bërë që klubi madrilen të sigurojë vazhdimësinë e bashkëpunimit me të, duke i dhënë fund dilemave për të ardhmen e tij. Në 14 paraqitje në sezonin aktual, Guler ka shënuar katër gola dhe ka dhënë shtatë asistime në të gjitha garat. Ai i ishte bashkuar Real Madridit në vitin 2023, nga Fenerbahçe. Deri më tani, turku ka zhvilluar gjithsej 126 ndeshje me fanellën e Real Madridit, me të cilin ka fituar pesë trofe, përfshirë titullin e kampionit të La Ligës dhe Ligën e Kampionëve.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar **"PICKLED"** SH.P.K. me seli në Fushë-Kosovë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. **811962473** dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa **"PICKLED"** D.O.O. sa sjedištem u Fushë-Kosovë, donelo odluku o prestani rada sa nrb. **811962473** ujedno imenovao Likvidatora o sprovodjenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potrazivanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability **"PICKLED"** L.L.C. with headquarters Fushë-Kosovë, has come to the decision to quit its business: **811962473** the company has appointet a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar "SMART ZEN " SH.P.K. me seli në Gjilan, pronare Aurora Kadriu ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 812365741 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa "SMART ZEN " D.O.O. Aurora Kadriu sa sjedištem u Gnjilane, donelo odluku o prestani rada sa nrb. 812365741 ujedno imenovao Likvidatora o sprovodjenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potrazivanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability "SMART ZEN " L.L.C. Aurora Kadriu with headquarters Gjilan, has come to the decision to quit its business: 812365741 the company has appointet a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.



Zvogëlim i kapitalit nga firma EUROFAMIS Sh.A

Firma "EUROFAMIS" Sh.A, me numër UNIK IDENTIFIKUES, NUI: 811306431, me seli në Shirokë, Suharekë, bën zvogëlimin e kapitalit nga vlera 910.000,00 euro në vlerën 10.000,00 euro.



>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- DENIS JUSUFI shpalle te pavleshme diplomen dhe deftesat e vitit I ,II,III te SHMLT ARKITEKT SINANI

- Shaban Kryeziu shpall te pavlefshme diplomën QK "11 Marsi" Prizren.

- Driton Bucaj shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shfmu " Abdyl Frasheri " Prizren.

- Armend Hoxhaj shpall te pavlefshme 3 dëftesat dhe diplomën Q K "11 Marsi " Prizren.

- Trim Rezniqi shpall të pavlefshme dëftesën e kl.10 të sh.m.p "Gjon N. Kazazi" Gjakovë.

- Sokol Haxhikadrija shpall të pavlefshme diplomën e gjimnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.

- Elidon Pylla B.I. shpall të pavlefshme certifikatën e TVSH-së, me nr. 33049408.

- Elidon Pylla B.I. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. 811149542 të lëshuar nga ARBK.

- Genti Kurhasku shpall të pavlefshme certifikatën e maturës shtetërore të sh.m. mjekësisë "Hysni Zajmi" Gjakovë.


100%
Fresh &
Natural
VIDAS
Llatte
drink
2%
TAMËL
PRODHUAR ME
FINESE DHE DASHURI
2,8%
Schmand
ajkë e freskët
sour cream
18% yndyrë
800g
JOGURT
DHALLË
100%
i Freskët
Natyral


ROYAL CROWN
RC
cola
ANNOUNCING THE 2017
QUALITY & SALES AWARDS
Quality & Sales Award Recipients
[Listed in alphabetical order]
★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo Philippines, Quality
★ Embotelladaora Central S.A Paraguay, Quality
★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. Guatemala, Qualtiy
★ Fluidi Sh.p.k. Kosovo, Quality
★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda Brazil, Quality
★ Interbrand S.A.L. Lebanon, Sales
★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. Czech Republic, Quality
★ Obi Zulol CJSC Tajikistan, Quality
★ Partex Sales sales Beverages Ltd. Bangladesh, Quality
★ Soft Drinks Georgia Georgia, Sales
Columbus, Georgia, USA
Since 1905
0.5L


MEKA
HALAL FOOD
TRADITË QË NGA
1992
MEKA
HALAL FOOD
PASHTETË
PULE
GLUTEN FREE
100% MISH PULE
CILËSI E GARANTUAR
PA KONSERVUES